

46 01 3.02.2016



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
KORÇË



Nr. Regj. 61002-00088-41-2016 (24 Regj)
Date regjistrimi 21.01.2016

Nr.Vendimi 41-2016-301 (24 Regj)
Date vendimi 23.01.2016

V E N D I M

Per marrjen e mases tesekuestroskonservative

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Korce, e perbere prej:

Gjyqtare Luljeta KOLE

Asistuar nga sekretare Hajrie Rusi, ne Korce me date 23.01.2016 ora 12.00, shqyrtoi ne seance gjyqesore ceshtjen penale qe i perket:

KËRKUES: Prokuroeia prane Gjykates te Shkalles se Pare Korce, perfaqesuar nga prokurore Dhorina Theodhori.

OBJEKTI: Caktim mase sigurimi pasuror "sekuester preventive"

Baza ligjore: Neni 274 i K.Pr.Penale.

Ne perfundim te gjykimit te zhvilluar ne prani te perfaqesueses te Prokurorise prane Gjykates te Shkalles se Pare Korce, gjykata pasi degjoi:

Prokuroren qe kerkoj pranimin e kerkeses dhe caktimin e mases se sigurimit pasuror "sekuester preventive" ndaj llogarise bankare te shtetases Marika Musa Bregu tek Alpha Bank,

Si dhe pasi shqyrtoi aktet dhe bisedoi ceshtjen ne teresi

V E R E N

Ne date 21.01.2016 ora 13.00 nga ana e Prokurorise prane Gjykates te Shkalles se Pare Korce, eshte paraqitur prane kesaj gjykate kerkesa per caktimin e mases se sigurimit pasuror "sekuester prebentive" ndaj llogarise bankare te shtetases Marika Musa Bregu tek Alpha Bank, bazuar ne nenin 274 te K.Pr.Penale.

Ne baze te neneve 278 dhe 271/1 te K.Pr.Penale, shqyrtimi i kesaj kerkeses ne fazen e hetimeve paraprake hyn ne kompetencen lendore dhe tokesore te kesaj gjykate, pasi eshte

gjykata ku mendohen te jene kryer veprimet qe dyshohen se perbejne veper penale, njeheras ku ka nendbanimin personi ndaj depozites bankate te se cilit kerkohej te vendoset sekuster.

Nga faktet dhe provat e paraqitura ne seance gjyqesore, rezultoi se në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë janë dërguar materialet hetimore me shkresën me nr. 145 prot, datë 19.01.2016 për veprën penale të "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Nga aktet e administruara në dosjen hetimore rezulton se nga ana e strukturave policore te Sektorit per Krimin Ekonomik e Financar ne Drejtorine Vendore te Policise Korce, jane administruar te dhena, per disa transakcione te dyshimta te ardhura ne emer te shtetases Marika Musa Bregu, e datelindjes 07.07.1952, banuese ne Erseke. Nga informacionet dhe te dhenat e administruara eshte konstatuar se në datat 07.12.2015 dhe 07.01.2016, kjo shtetase ka përfituar nga Belgjika, respektivisht shumat 5.879 Euro dhe 6.992 Euro me urdhërues të tyre shoqërinë "TEINTEX BVBA". Transfertat e mësipërme kanë mbërritur në bankën Alpha. Nisur nga fakti që urdhërues për transfertat ndaj kësaj shtetaseje 64 vjeçare është një kompani e huaj dhe se nga fakti se janë ndeshur shpeshhere raste të përdorimit të personave të tretë për t'u shfaqur në bankë si përfitues i transfertave duke shmangur përfituesin e vërtetë paidentifikuar oficerët e policise kanë vijuar verifikimin e mëtejshëm lidhur me këtë shtetas dhe familjarët e saj, verifikim nga i cili ka rezultuar se:

- Kjo shtetase ka hapur llogari në Lekë në këtë bankë më datë 09.10.2015.
- Nuk ka kryer veprime, por pas mbërritjes së transfertës së datës 07.12.2015 nga Belgjika, ka kryer konvertimin e shumës së përfituar në lekë, nga të cilat më datat 14.12.2015 dhe 31.12.2015, ka tërhequr në total shumën prej 76.600 Lekë.
- Veprimet janë kryer në degën e Bankës Alpha në qytetin e Ersekës.
- Në lidhje me transfertat e përfituara shtetasja Marika Bregu ka deklaruar se fondet vijnë nga vajza e saj që jeton në Belgjikë.
- Nga kërkimi për shtetasen e sipërpërmendur dhe familjarët e saj Foti Seit Bregu i datelindjes 22.07.1943, Vadjola Foti Bregu e datelindjes 19.06.1983, Dhimitraq Foti Bregu i datelindjes 03.05.1972, Oltjon Foti Bregu i datelindjes 11.12.1978, rezultojnë transakcione të vlerave vetëm në emër të shtetases Marika Bregu e cila përveç transakcioneve të sipërcituara, më datë 10.12.2012, ka derdhur në Bankën Kombëtare Tregtare shumën prej 1.000.000 Lekë dhe e ka investuar në depozitë me afat.
- Nga kërkimi në burime të hapura për urdhëruesin shoqërinë "TEINTEX BVBA" rezulton te jete një fabrikë për punim litarësh në Belgjikë.
- Nga kërkimi në sistemin TIMS rezultojnë hyrje dalje në pikën e kalimit kufitar Kapshticë te shtetasve Dhimitraq, Marika dhe Oltjon Bregu që nga viti 2005 e në vijim me një shpeshësi prej 1 apo 2 herë në vit.
- Në lidhje me shtetasen Vadjola Bregu rezultojnë hyrje dalje në pika të ndryshme të kufirit nga të cilat vecohet ajo e datës 26.09.2015, ku ka udhëtuar nga pika e kalimit kufirit të Murriqanit me një makinë me targa OBEV4444. Në të njëjtën makinë ka udhëtuar dhe shtetasi Ervin Meti Hatija i datelindjes 14.07.1986.
- Nga kërkimi në të dhënat për këtë shtetas nuk rezultojnë transakcione. Ky shtetas ne harkun kohor 2007-2009 eshte deportuar nga shteti grek 18 here. Nga verifikimet e meteleshme te kryera per familjaret e shtetasit Ervin Meti Hatija, lindur ne Fier dhe banues ne Mbrostar-Ura, Fier, kare rezultuar se vellai i tij Ilir Hatija, ne dt.31.10.2012 eshte shpallur ne kerkim policor nga

strukturat e Komisarariatit të Policisë Lushnje, pasi dyshohet se në dt.29.10.2012, në fshatin Kolonje-Lushnje, në bashkëpunim dhe me persona të tjerë, kanë vjedhur me armë zjarri shtetasit Ilir Gjermani, Erkens Gjermani dhe Alban Boci. Ndaj këtij shtetasi ishte marrë masa e sigurisë "arrest me burg" nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje, me vendim nr. 178, dt. 18.12.2012, për veprën penale "Vjedhje me armë" në bashkëpunim të parashikuar nga neni 140-25 të Kodit Penal. Në dt. 05.11.2013, ky shtetas është ekstraduar nga Interpol Tirana, në Komisarariatit të Policisë Rinas, ku është marrë në dorezim nga patrulla e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Nderkohe që vëllai tjetër i shtetasit Ervin Meti Hatija, i cili quhet Bledar Hatija ka qenë person i denuar me parë, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendim nr. 74, dt. 02.03.2007.

Nga sa më sipër, bazuar në mungesën e dokumentacionit për justifikimin e transfertave të përfituara nga shtetasja Marika Bregu, faktin që urdhëruesi është një shoqëri kurse nga deklaratat e saj rezulton se fondet janë nga vajza që jeton në Belgjikë, ekzistenca e tipologjive ku shtetas të ndryshëm përdoren për përfitime transfertash pa u shfaqur përfituesi real i shumave, ka lindur një dyshim i bazuar për burimin e fondeve dhe aktivitetin e saj.

Sipas informacionit, rezulton se me urdhrin nr.2, dt. 11.01.2016 të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave Tirane, është vendosur bllokimi i përkohshëm i transaksioneve dhe veprimeve financiare për shtetasen Marika Bregu.

Duke ju referuar sa më sipër, Prokuroria ka filluar procedimin penal nr.66 të vitit 2016 dhe është duke hetuar për veprën penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" të parashikuar nga neni 287 i K.Penal.

Faktet e mësipërme rezultojnë nga aktet shkresore të paraqitura nga Prokuroria dhe të shqyrtuara në seance gjyqësore:

- Urdhër për regjistrimin e procedimit penal datë 20.01.2016,
- Shkresa me nr. 145 prot, datë 19.01.2016 për dërgimin e materialit kallezues,
- Informacion për referimin e veprës penale datë 19.01.2016,
- Printime nga sistemi TIMS për shtetasit Vadjola Bregu, Oltjon Bregu, Dhimitraq Bregu, Foti Bregu, Marika Bregu,
- Printime nga sistemi TIMS për shtetasit Ervin Hatija, Ilir Hatija, Bledar Hatija,
- Urdhrin nr.2, dt.11.01.2016 i Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave Tirane
- Shkresë e Alpha Bank datë 20.01.2016 bashkangjitur dokumentacioni që i përket llogarise të shtetasen Marika Bregu.

Nga sa më sipër, duke mbajtur parasysh kushtet për caktimin e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive të parashikuar nga neni 274 i K.Pr.Penale, gjykata vlerëson se ka vend që të pranohet kërkesa për caktimin e një mase të tillë.

Neni 274 i K.Pr.Penale përcakton se:

"1. Kur ka rrezik që disponimi i lire i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente urdheron sekuestrimin e tij me vendim të arsyetuar.

2. Sekuestroja mund të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal.

3. Kur ndryshojnë kushtet e zbatimit, gjykata, me kërkesën e prokurorit ose të të interesuarit, e heq sekuestron.

Gjykata vlereson se masa e sigurimit pasuror të sekuestrës konservative, i pergjigjet të gjitha kushteve ligjore dhe është në përputhje me rëndesinë e faktit dhe shkallën e nevojave të marrjes të nje mase të tillë për rastin konkret, me qëllim për të garantuar ecurinë e mëtejshme të hetimeve, pasi :

Se pari: Konstatohet një rrezik real për kryerjen e veprimeve apo transaksioneve të tjera nga ana e shtetases Marika Bregu, të tilla që krijojnë dyshim të arsyeshëm se disponimi i lire i llogarise bankare të poseduar prej kesaj shtetaseje mund të vijojë zgjatjen e pasojave të vepres penale objekt i këtij procedimi.

Se dyti: Vendosja e masës së sigurimit të kërkuar nga ana e prokurorisë, është jo vetëm me karakter të ngutshëm, por edhe e justifikuar dhe provuar në rrethanat konkrete të çështjes. Për këtë mbahet parasysh koha e shkurtër nga hapja e llogarise dhe terheqjet që janë bërë nga llogaria, e pare kjo edhe në lidhje me deklarinimin e pavertete para punonjesve të bankës lidhur me burimin e ketyre të ardhurave, rrethana këto që e bëjnë të besueshëm dyshimin për një veper penale konkrete në fushën financiare.

PËR KËTO ARSYE

Ne baze të nenit 244, 245 dhe 274 të K.Pr.Penale

V E N D O S I

-Pranimin e kërkesës të Prokurorisë pranë Gjykatës të Shkallës së Parë Korçe.

-Vendosjen e masës së sigurimit pasuror "sekuenster preventive" mbi llogarinë bankare në leke të shtetases Marika Musa Bregu, pranë Alpha Bank Albania sh.a., me nr. AL31902445774321030112203144.

-Kunder vendimit lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit Korçe, brenda 10 ditëve nga e nesërmja e shpalljes, për subjektet e interesuara afati fillon nga e nesërmja e venies në dijeni lidhur me këtë vendim.

U shpall në Korçe, në datë 23.01.2016.

SEKRETARE
Hajrië RUSI



GJYQTARE
Luljeta KOLE



KANCELARE
LUBIANA ANULLI



VERTETOHET
NJESIA E
FOTOKOPJES

ME ORIJINALIN 95 ndodhet në dosje
KORÇE ME 25-11-2020

Arhiviste Marinela Gashi